



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 442/2019

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rustem Thaqi kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Adnan Konushevci anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Valbona Millaku Foniqi, duke vendosur përkritazi me ankesat e subjektit politik Partia Kosovskih Srba (PKS) me seli në Laposaviq, paraqitur kundër subjektit politik Lista Serbe, me seli në Mitrovicën e Veriut, si dhe kryesuesve dhe anëtareve të Vendvotimeve të këtij subjekti politik, për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhor në ditën e votimit për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me datë 09.11.2019, mori këtë:

## V E N D I M

**HUDHEN** të pasafatshme ankesat: Anr.442/2019, Anr.443/2019, Anr.444/2019 dhe Anr.445/2019, të gjitha të datës 07.11.2019, të paraqitura nga subjekti politik Partia Kosovskih Srba (PKS), me seli në Laposaviq, kundër subjektit politik Lista Serbe, me seli në Mitrovicën e Veriut, si dhe kryesuesve dhe anëtareve të Vendvotimeve të këtij subjekti politik, për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhor në ditën e votimit për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 06.10.2019.

## A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 07.11.2019, ka pranuar ankesat: Anr.442/2019, Anr.443/2019, Anr.444/2019, Anr.445/2019, nga subjekti politik Partia Kosovskih Srba (PKS), me seli në Laposaviq, në të cilat pretendohet se gjatë procesit zgjedhor, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 06.10.2019, nga ana e këtij subjekti politik, janë vërejtur parregullsi në ditën e votimit.

- Në ankesën Anr.442/2019, pretendohet se gjatë ditës së zgjedhjeve të mbajtura me datë 06.10.2019, nga subjekti politik Lista Serbe, janë shkaktuar një numër i madh i shkeljeve, të cilat kanë ndodhur para se gjithash me falsifikimin e procesverbaleve nga vendvotimet, të cilat kanë shkaktuar shkeljen e vullnetit të serbëve në Kosovë, dhe i kanë mundësuar Listës Serbe që vetit me mashtrim t'i atribuoj rezultatet sipas së cilave i ka fituar 98% vota serbe. Me tutje në ankesë theksohet se si parregullsi tjera të vërejtura janë edhe se në mënyrë të organizuar dhe masive janë shkatërruar fletë votimet e partive tjera serbe, përmes votimit të njerëzve të vdekur, deri te kërcënimet, presionet, prurjen e organizuar të serbeve nga Serbia, largimi nga vendet e punës deri te votimi i personave të njëjtë edhe nga 18 herë, dhe për të cilat e kemi informuar qendrën operative të KQZ-së, në ditën e zgjedhjeve, thuhet në ankesë. Parashtruesi i ankesës kërkon marrjen e vendimit për rinumërimin e fletë votimeve në vendvotimet në shumicë serbe.

- Në ankesën Anr.443/2019, pretendohet se në ditën e procesit zgjedhor me 06.10.2019, në vendvotimin 1201/02R shkolla e mesme në Leposaviq, ku kryesuese ka qenë Jovana Jakovleviq, është ardhur deri te pa rregullsitë serioze nga ana e anëtarit të KV (BO) Jelena Petroviq Kostoviq nga Lista Serbe. Më tutje në ankesë theksohet se Jelena Petroviq Kostoviq gjatë procesit të numërimit në mënyre aktive ka anuluar votat e PKS-së, duke rrumbullakuar edhe ndonjë subjekt tjetër politik nga fletëvotimi. Po ashtu në ankesë theksohet se e njëjta nuk u ka kushtuar vëmendje vërejtjeve të përsëritura nga ana e vëzhguesve të OSBE-së, dhe ka vazhduar me shkatërrimin e votave të PKS-së, dhe se zonja e cekur qysh me datë 07.10.2019 është arrestuar me urdhrin e prokurorit dhe i është caktuar masa e paraburgimit, por para se gjithash në procesverbal nuk na është mundësuar të fusim vërejtje. Sipas paraqitësit të ankesës në këtë vendvotim procesi zgjedhor nuk ka qenë në rregull dhe kërkon qe i njëjti të anulohet.
- Në ankesën Anr.444/2019, pretendohet se në ditën e procesit zgjedhor me 06.10.2019, në vendvotimin 1203B në fshatin Vraqevo, Komuna Leposaviq, ka ardhur deri te një dëmtim i rëndë i procesit zgjedhor, ku behët fjalë se kryetarja e BO, Marina Salkoviq e Listës Serbe, në kundërshtim të ligjit dhe vendimit të KQZ-së, ka lejuar votimin me dokumente personale serbe, me dokumente të skaduar të UNMIK-ut, si dhe personave të cilët ishin të evidentuar që kishin votuar dhe personave të cilët nuk ishin të regjistruar në vendvotimin e lartcekur, por kanë mundur që aty të votojnë. Më tutje në ankesë theksohet se e përmendura Marina Salkoviq nuk ka lejuar qe deri ne fund të procesit zgjedhore, qe në procesverbal të shënohet asnjë ankesë, dhe se në lajmërimin e vëzhguesit nga PKS, për parregullsitë në këtë vende votim ka reaguar edhe Prokuroria e Kosovës dhe të përmendurës me datën 07.10.2019 i është caktuar paraburgimi. Paraqitësi i ankesës thekson se pranë të gjitha këtyre, OIK dhe KQZ, zgjedhjet (votimet) në këtë vendevotim i konsideron të rregullta dhe të kryera pa asnjë parregullsi, dhe kërkon qe zgjedhjet në këtë vendevotim të anulohen si të parregullta.
- Në ankesën Anr.445/2019, pretendohet se gjatë ditës se zgjedhjeve në të gjitha vende votimet në veri të Kosovës, e ku kryesuesit të KV (BO) ishin nga radhët e Listës Serbe, është ardhur deri te shkelja e rende e procesit zgjedhor dhe votimit me dokumente jo valid të UMNIKU-t, si dhe me dokumente serbe, dhe deri te votimi i shumt i personave të njëjtë nëpër disa vendvotime. Më tutje në ankesë theksohet se ka ekzistuar dhe është implementuar plani i Listës Serbe qe të pamundësohet çfarëdo ankesë në vende votime, e të cilat është dashur të evidentohen në librin e ankesave, dhe për këtë problem për votim të organizuar të votimit të personave në disa vende në veri të Kosovës ne kemi informuar qendrën operative të KQZ-së, z.Nexhmedin Hysenin qysh në ora 11:15 dhe 06:10, por përveç kësaj veprimet e përmendura nuk ka arritur ti evitoj, dhe se veprimet me masovike dhe me të organizuara në komunat Zveqan, Leposaviq, Mitrovicë e Veriut, ku në përgjithësi procesin zgjedhore e kontrollojnë aktivistet e Listës Serbe. Po ashtu në ankesë theksohet se Qendrën operative të KQZ-së, qysh në ora 08:00 e kemi informuar se në vendvotimet në veri në paravanin për votim gjinden të vendosur fletëvotime me votën e shënuar për numrin 135 Listës Serbe, dhe me kombinimin e shënjuar për deputet 1,2,3,4,5, dhe se Qendra operative e KQZ-së, pas paraqitjes ka reaguar por pa ndonjë efekte të madh edhe anëtarët e OIK, nga veri kane vizituar disa vendvotime, dhe nga aty kane larguar instruksionet e cekura për atë se si duhet

të votohet, vetëm në ora 14:30, dhe se për këto arsye për të cilat KQZ, i ka ditur qysh nga ora 08:00, ne mendojmë se zgjedhjet në veri të Kosovës, duhet të anulohen si dhe rezultate të tilla nuk duhet të pranohen sepse nuk janë shprehje e vullnetit të qytetareve, por pasqyre dhe pasoje e organizuar e mashtrimit zgjedhor të Listës Serbe.

Paneli, paraprakisht ka vlerësuar se ankesat: Anr.442/2019, Anr.443/2019, Anr.444/2019 dhe Anr.445/2019, të datës 07.11.2019, janë për nga përmbajtja të njëjta, për nga natyra e shkëljes së pretenduar janë të njëjta, janë paraqitur nga e njëjta palë ankuese kundër subjektit të njëjtë politik, prandaj Paneli, bazuar në nenin 8 paragrafi 3 i Rregullave dhe Procedurave Nr.02/2015, të PZAP-it, në të cilën përcaktohet se: *Me qëllim të lehtësimit të shqyrtimit të ankesave kryesuesi i panelit vend marrës mund të vendos ta bëjë bashkimin e ankesave që përmbajnë në vete çështje të ngjashme dhe se ato ankesa të trajtohen me një vendim”, andaj Paneli, bëri bashkimin e ankesave dhe për të njëjtat vendosi me një vendim, si në dispozitiv të këtij vendimi.*

PZAP-i, pasi që shqyrtoi afatshmërin e ankesave, gjeti se :

#### **Ankesat janë të pasafatshme**

Për të gjitha parregullsitë që mund të paraqiten në ditën e votimit, ankesa mund të paraqitet në PZAP, brenda 24 orëve nga momenti i mbylljes së Qendrës së Votimit sipas nenit 119 par.1 të LZP-së. Në rastet konkrete qendra e votimit është mbyllur më datë 06.10.2019 në ora 19:00, ndërsa ankesat Anr.442/2019, Anr.443/2019, Anr.444/2019 dhe Anr.445/2019, nga parashtruesi i ankesave janë paraqitur në PZAP, me datë 07.11.2019, që do të thotë pas afatit të paraparë ligjor të përcaktuar me nenin 119 par.1 të LZP-së.

Duke u nisur nga arsyet e theksuara me lart e në kuptim të nenit 118 dhe 119 të LZP-së dhe nenin 6 par.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Nr.02/2015, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

#### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Anr. 442/2019 më datë 09.11.2019



**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.